

Arrestohet një person në Podujevë, shtiu me armë gjatë një ahengu

LAJME

25/07/2025 10:04

f

t

l

Një person është shoqëruar në stacionin policor në Podujevë pasi dyshohet se ka shtënë me armë zjarri gjatë një ahengu.

Rasti ka ndodhur më 24 korrik 2025, rreth orës 22:32, në rrugën “Skënderbeu” në Podujevë.

Sipas Policisë së Kosovës, njësitë policore kanë ndërhyrë dhe kanë konfiskuar një armë zjarri dhe një karikator pa fishek nga i dyshuari, mashkull kosovar, transmeton [lajmi.net](#)

Pas intervistimit dhe konsultimit me prokurorin e shtetit, i dyshuari është liruar në procedurë të rregullt, ndërsa ndaj tij është iniciuar rast penal për “Posedim dhe përdorim të paautorizuar të armës”.

Policia njofton se hetimet lidhur me rastin janë duke vazhduar./[lajmi.net/](#)

Artikuj të ngjashëm

July 27, 2025

Kryeprokurori Isufaj:
Radoiçiqi kërkoi heqjen e urdhër-arrestit në këmbim të informatave...

LAJME TË FUNDIT

Kryeprokurori Isufaj: Radoiçiqi kërkoi heqjen e urdhër-arrestit në...

Vuçiq: Nuk vendosim sanksione ndaj Rusisë, Staroviq foli pa kujdes

Numër i madh i vatrave të zjarreve edhe...

Ndërtimtaria sektor me rrezik të lartë, kërkohen masa nga Inspektorati